



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 1503 Prot

Shkodër, më 31.01.2018

V E N D I M

Nr. 40 datë 31.01.2018

“Për delegimin e kompetencave”

Në mbështetje të nenit 8, 9 të ligjit nr 139/2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, në nenet 28, 29 të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006. “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. te ndryshuar, udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, te ndryshuar,

V E N D O S A :

- I. Delegimin e kompetencës së titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkoder, zv/kryetarit, znj. Emilja Koliqi, për nënshkrimin e akteve të procedurave të prokurimit, vlera e të cilave, brenda një viti kalendarik është më e vogël se 800,000 (tetëqind mijë) lekë.
- II. Delegimin e kompetencës si nëpunës i autorizuar, Bashkia Shkoder, zv/kryetarit, zj. Emilja Koliqi, për kryerjen e pagesave për zërat e shpenzimeve: paga, sigurime shoqerore e shendetesore, TAP, transferata, shpenzime per energji elektrike, uje dhe poste.
- III. Kompetencat e deleguara, do të ushtrohen për periudhën, nga hyrja në fuqi e këtij urdhëri deri në datën 31.12.2018.

- IV. Raportimi të kryhet tek nëpunësi Autorizues, me shkrim, çdo muaj pasardhës, për realizimin e detyrave të ngarkuara.
- V. Zv/kryetari, nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen web te Bashkise Shkoder.

